

Nexhat Daci, gjatë emisioni Click në RTV 21 i është përgjigjur edhe vërejtjes së analistit Driton Selmanj, se takimet e tij me Shefqet Krasniqin si dhe pjesëmarrja e fjalimi në një prezentim të një libri nga ky, e ka zbehë dhe e ka bërë jo të besueshëm edhe vet akademinë, pasi që Krasniqi është nën hetime nga prokuroria.

Daci i ka arsyetuar këto takime dhe e ka quajtur Krasniqin si shumë produktiv, madje ka thënë edhe se librat e tij janë të shkruara sipas të gjitha procedurave më të besueshme edhe pse ai nuk ka shumë njohuri mbi shkencat shoqërore.

Daci ka shtuar se për të është gëzim i madh që dr. Shefqet Krasniqi është anëtarë i Lidhjes së Dijetarëve Muslimanë.

[youtube align="none"]height="400"width="100%"http://www.youtube.com/watch?v=rYqndV0iLPs[/youtube]